

DAXOROL Reibeputz

■ **Vendet e përdorimit:** - Llaç struktural plastik për dekorimin e fasadave dhe sipërfaqeve të brendshme sipas DIN 18350. Përdoret si shtresë përfundimtare mbi të gjitha llojet e llaçeve të grupeve P2 dhe P3, llaçeve të gipsit të grupit P4, pllakave të betonit dhe të gipsit si dhe në shtresa të ashpra dhe rezistente me strukturë të gërryer.



■ **Karakteristikat:**

I padepërtueshëm, rezistent ndaj ujit sipas DIN4108, P. Org.1. I pandjeshëm ndaj gazrave agresive industriale, shumë rezistent, ngjites, me aftësi difuzive, alkalirezistent, përpunohet me lehtësi dhe pa ndërprerje, nuk është i dëmshëm ekologjikisht, pa erë.

■ **Tonet e ngjyrave:**

E bardhë. Nuancohet me maximum 5 % DaxoColor tone të plota ose nuanca. Nuancim kompjuterik me Sistemin DaxoMix për përzierje.

■ **Përdorimi:**

Llaçi tërhiqet me mistri adekuate nga rostfraj, ndërsa strukturohet me mistri plastike. Spërkatje maqinerike me aparate adekuate të llaçeve.

■ **Udhëzime për rrezique:**

Të mos punohet me llaç struktural në raste të errërave të fuqishme ose në temperatura mbi 20 °C, sepse dhe mund të paraqiten dallime në nuancën e ngjyrave. Për vazhdim të punimeve në sipërfaqen e njëjtë të përdoret materiali i njëjtë. Temperatura gjatë përpunimit të mos jetë nën +5°C. Pas përdorimit mjetet e punës të lahen me ujë. Në rast të ngjeshjes me sytë apo me lëkurën, menjëherë të pastrohen me ujë. Të mos hidhet në kanalizim/ ujëra ose në tokë.

■ **Harxhimi:**

2 – 2.5 kg / 1m², varësisht nga baza.

■ **Vërejtje:**

Për reciklim mund të përdoren vetëm ambalazhet e zbrazëta. Mbeturinat e thata mund të hudhen në mbeturinat shtëpiake.